

Blerim Destani ngjitet shkallëve të Holivudit

Pas suksesit me rolin e tij të Shestanit në filmin shqiptar “Koha e kometës” duket se aktori nga Tetova Blerim Destani po ngjitet lartë e më lartë në kinematografinë ndërkombëtare. Duke pasur parasysh sukseset e njëpasnjëshme të aktorit, sidomos të arritura gjatë vitit 2008, dhe të vazhduara në fillim të këtij viti, në vijim një përmbledhje nga projektet e tij holivudian, këtu të përfshirë edhe projektin më të ri që sapo mbaroi xhirimet në Atlanta...



Ne filmin holivudian „Get Low“, këtu Blerimi shihet me aktorin e mirënjohur Robert Duvall.



Një skenë gjatë xhirimeve (Get Low).

Një njeri i moshuar, Felix Bush (Robert Duvall) pas 45 vjetëve jetë në izolim në kasollen e tij në mes të pyllit, trondit qytetin me idenë që dëshiron të organizoj funeralin e tij. Dëshiron që vet të jetë prezent gjatë funeralit të tij dhe t'i dëgjoj gjithë fjalimet që do të mbahen për jetën e tij. Kuptohet që edhe vet ai do të mbaj fjalimin e tij gjatë ceremonisë. Për këtë ka një arsye të thellë, pasi ka një brerje të ndërgjegjes, për një fatkeqësi që ka ndodhur para 45 vjetëve ku kanë humbur jetën një grua dhe një burrë gjatë djegies së një shtëpie. Për atë ngjarje atëbotë ai ka qenë i akuzuar si shkakuar i tragjedisë. Kjo edhe e ka bërë që të jetoj i tërhequr në kasollen e tij i shoqëruar vetëm nga mushka e tij. Kjo, e ndan qytetin në përkrahës dhe kundërshtarë të idesë për një ceremoni të tillë. Gary, është në anën e kundërshtarëve dhe mundohen ta pengojnë. Filmi mbaron me fjalimin e Plakut Bush, ku ai e shpalos motivin e tij kryesor që e ka shtyrë drejt një ideje të tillë. Ajo është dashuria e

parealizuar pikërisht nga gruaja që e ka humbur jetën në atë tragjedi 45 vjet më parë... Kjo është përmbajtja e filmit më të ri holivudian “Get Low” i cili sapo mbaroi xhirimet njëzetetë ditëshe në Atlanta. Skenarin 126 faqesh për “Get Low”, që përafërsisht do të thotë 120 minuta film, kanë shkruar C. Gaby Mitchell, Chris Provenzano, ndërsa Regjisori i filmit është Aaron Schneider (fitues i çmimit Oscar për filmin e shkurtër „Two Soldiers“ në vitin 2004). Për peshën dhe rëndësinë e këtij filmi flet fakti ai është në produksion të kompanisë „Zanuck Company“ me producent Dean Zanuck, i cili është nipi i njërit nga themeluesit e industrisë kinematografike të Holivudit Darryl F. Zanuck. Në „Get low“ ishin të angazhuar yjet holivudianë si Robert Duvall, Bill Murray, Sissy Spacek, Scot Cooper, Lucas Black dhe Bill Cobbs. Por, një yll i ri po ngjitet lartë e më lartë në fushën e kinematografisë ndërkombëtare. Ai nuk është një person i panjohur: as më

shumë e as më pak ai është pikërisht aktori ynë Blerim Destani. Me rolin e Shestanit në filmin shqiptar “Koha e kometës” ai e bëri një rrumbullakim të përvojës së tij nga projektet paraprake, dhe realizimi i këtij roli, ia hapi dyer të reja, pasi me këtë rol u dëshmuua edhe potenciali i tij aktoresk. Mund të thuhet që roli i Shestanit i parapriu suksesëve të Blerimit. Shestani ishte roli i tretë, ndërsa Gary në „Get low“ është roli i gjashtë. Por jo vetëm kaq! Aktori ka qenë i angazhuar edhe më parë në dy projekte holivudiane. Në muajin mars të vitit 2008 Blerimit i erdh oferta për angazhim në filmin me titull pune „Separated city“, ndërsa tani në distribuim paraqitet si “The Truth About Men“. Sapo e lexoi skenarin, e vërejtj se fjala është për projekt serioz në kuadër të standardeve bashkëkohore kinematografike në produksion të „New Holland Pictures“. Autor i skenarit ishte Tom Scott, ndërsa regjia i ishte besuar Paul Middleditch. I pëlqej qasja e skenari

veçanërisht si i trajtonte temat shumë të njohura të relacioneve mes njerëzve. Fjala është për një komedi të zezë, (diçka ngjashëm si filmi „Closer“). Ku nëpërmjet situatave komike dalin në pah dramet më të dhimbshme në raportet ndërnjerëzore. Personazhi i cili i ishte ofruar ishte dirigjent i orkestrës simfonike të Zelandës së Re dhe ishte me prejardhje franceze. Dirigjenti ishte i vetmi personazh që disi ishte mbi gjithë situatën në të cilën ishin ndërlidhur personazhet tjerë. Ishte i vetmi njeri që kishte të qartë se çfarë është, çfarë bën dhe çfarë dëshiron të bëjë në të ardhmen. Dhe gjithë kjo paraqitej me një energji shumë pozitive, sa që në shikim të parë dukej se është i vetmi personazh që përherë buzëqesh në film. Pra, një qëndrim i tillë ndaj jetës e shtyn personazhin kryesor Katrien (Rhona Mitra) të dashurohet në të duke kërkuar që të përjetoj sado pak nga energjia e tij. Por, diçka do të ndryshonte! Gjatë xhirimeve Blerimi kërkoi nga



Blerimi Destani gjatë xhirimeve për filmin „The truth about men“.



Gjatë xhirimeve për filmin „At World's End“.

producenti që të ndryshohet prejardhja e personazhit nga francez në shqiptar, gjithnjë duke dashur që në ekranet e kinematografisë shqiptarët të paraqiten edhe nëpërmjet personazheve të tillë si dirigjent dhe me plot sharm, e jo ashtu siç zakonisht paraqiten. Kërkesa u pranua si nga producenti ashtu edhe

nga skenaristi dhe regjisori. Ndërsa oferta për angazhim në filmin „At World's End“ i erdhi gjatë kohës së xhirimeve në Zelandën e Re nga njëri nga producentët Mark Overett, i cili ishte producent në të dy filmat. Ju ofruar roli i një Kameramani gjerman (Rudy Huber). Fjala është për një

film të zhanrit triler/aksion ku një ekip televizive duke xhiruar një film dokumentar në xhungël hasin në një lule të veçantë e cila besohet se po qese njeriu i hanë petalet e saj do të ketë jetë të amshueshme. Ekipi televiziv has në këtë lule në mes të xhunglës duke mos e ditur se në kërkim të po të njëjtës lule janë vënë shumë aventurier dhe mercenar nga të katër anët e botës. Filmi është përplot me skena aksioni si dhe me shumë efekte speciale. Angazhimi i Blerim Destanit në projektet ndërkombëtar dhe me kaq peshë tregon qartë se edhe ne kemi vlera të mirëfillta që mund të jenë pjesë e kinematografisë botërore. Nga burime tonat të afërta me Blerimin mësuam se puna e tij ka lënë përshtypje të shkëlqyeshme si te kolegët aktor ashtu edhe tek regjisori dhe producenti, kështu që gjatë kohës së xhirimeve Blerimit i janë bërë disa oferta shumë atraktive në projekte të ardhshme holivudiane. Pas roleve se deritanishëm, angazhimi i Blerimit, veçanërisht në filmin „Get low“, është një sukses i veçantë për karrierën e tij. Kjo po ashtu është një gjë me rëndësi të veçantë për të gjithë shqiptarët, pasi që pas aktorit tonë të mirënjohur Bekim Fehmiu, edhe Blerim Destani po ngjitet shkallëve të suksesit në arenën më të rëndësishme të kinematografisë botërore.

FAMILJET, një film-serial i bashkëprodhuar Kosovë- Shqiperi

Përmes bashkëpunimit të shtëpisë filmike 'Arena' në Kosovë dhe kompanisë Digitalb të Shqipërisë, regjisori dhe aktori Sunaj Raca nga Prishtina, ka sjellë serialin më të ri (një prodhim në HD) "Familjet". Një serial ku përpos problematikave kolektive, ka në epiqendrën fatin e individit. Atë fat që shpesh herë rastësia e bën të ndryshojë drejtim kryekëput. Subjekti i referohet familjeve mafioze, trafikimit, keqdashjeve...dukuri këto që do të shpalosen për së pari në tri seritë që kanë filluar prej 2 shkurtit. Projekti parashikon që në fund të prillit të jenë gati edhe 5 seritë e tjera që do të vijojnë ngjarjet e lëna pezull. Në film shtrihen tri linja kryesore: ajo e presë (viktimitës) së dukurive mafioze, punës së policisë përmes agjentëve dhe linjat kriminale e cila përfshin dy familje keqbërësish, njëra në Tiranë dhe tjetra në Prishtinë.

Në këto pjesë të para të serialit, aktorët shqiptarë nga Shqipëria zënë vetëm 30% të filmit, pjesa tjetër janë aktorët shqiptarë nga Kosova, raport ky që do të ndryshojë ndjeshëm në vazhdimin e serive të tjera. Një nga linjat kryesore është ajo e Tonit luajtur nga aktori i teatrit Arben Derhemi. Ai është kryefamiljari i një familje krejt të zakonit, që punon si automekanik për të mbajtur familjen. Rastësia e përlyen në një ËC publike me rrjetet e eurolotove. Joshja e momentit për të fituar shuma parash deri atëherë të munguara, e bën në vazhdim të kthehet në një borxhli të rëndomtë që edhe pse kërkon të dalë, është tepër vonë. Pasoja e një veprimi të nxituar e përlyejnë aq shumë sa si kërcënim i rrëmbejnë vajzën e vetme. Për pasojë e gjithë situata në familje i ikën nga duart, gruaja i largohet e ngelet i vetëm me kërcënimet e përtej receptorit.

Tinka Kurti është një tjetër pjesëmarrëse e palës shqiptarë në rolin e vjehrrës së Tonit (Ben Derhemit). Deri tani shfaqja e saj në film zë një fare të vogël prej 45 sekondash por roli do të marri përmasa të tjera në seritë në vazhdim. Ashtu sikundër do të shfaqen edhe aktorët e tjerë shqiptarë që do të plotësojnë filmin si Rreshat Arbana, Raimonda Bulku, Guljem Radoja dhe Fatos Sela.